

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"PRIME ELITE,, SH.P.K

KREU - 1

THEMELIMI-EMRI-OBJEKTI-KOHEZGJATJA –SELIA

Neni-1 -Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me dt 22.07.2022 bazuar ne kerkesat e ligjit 9901 dt 14-04-2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqërite tregëtare,, (i ndryshuar) me vullnetin tim te lire (sot e ne vazhdim Ortake themelues) une Englantina Prifti , shtetas Shqiptar i identifikuar me Karte identiteti nr H35925104D i ditelindjes 25/09/1973 lindur dhe banues ne Himare vendosa te krijojë Shoqerine me përgjegjësi te kufizuar "**PRIME ELITE,,** Sh.p.k (këtej e tutje "shoqëria,,).

Shoqeria vepron ne perputhje me ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqërite tregëtare,, (i ndryshuar), me ligjin 9723 dt 03.05.2007 per Qendren Kombetare te Biznesit (te ndryshuar) e te tjera ligje ne fuqi te legjislacionit Shqiptar dhe Statuti i Shoqerise.

Neni-2 – Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete si vijon:

1-Shitje -Blerje te pasurive te paluajtshme.

2-Sherbim ndermjetesimi :

a.Ne shitjen e pasurive te paluajtshme si dhe çdo lloj pasurie tjeter.

b.Ne dhenie dhe marrje me qira te pasurive te paluajtshme.

c.Ne shitje biznesi, si dhe çdo sherbim tjeter ne lidhje me tregun imobiliar.

3-Keshillime per menaxhim biznesi.

Neni-3 -Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë do te jete pa afat.

Neni-4: Selia e shoqërisë

1-Selia e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar "**PRIME ELITE,,** SH.P.K do te jetë në adresën:

Rr.Jorgji Bollano,Lagja.Spila,Godina Nr.14, Himare

2- Adresa e shoqërisë per qëllime komunikimi elektronik eshte si vijon: primelitehimara@gmail.com

KREU – 2 KAPITALI

Neni-5: Kapitali themeltar

1-Kapitali themeltar fillestar I Shoqërisë është 100.000 (njqindmije) leke.

Numeri i kuotave është 1 (nje)

Ortaku i vetem themelues znj. Englantina Prifti eshte zoterues i 1 (nje)kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (njqindmije) leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

2-Kontributi ne para do te paguhet plotesisht pas rregjistrimit ne QKB.

Neni-6 Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapiatalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve , e cila merr vendim ne te njejta kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7- Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU-3

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni-8 Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuse me te njejtin rend dite.

Neni-9 Menyrat e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni – 10 Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejte vote që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare,, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët , që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni – 11 Marrja e vendimeve

- 1- Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotrueseve të kapitalit , të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2- Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni – 12 Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënie ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI-13 Administrimi

Administrator i Shoqërisë do të jetë znj. Englantina Prifti , afati i emerimit është 5 vjet me të drejte ripërteritjeje. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni-14 Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejte e detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) Raportojnë përpara Asamblese se përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

f) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administrаторet janë të detyruar të therrasin Asamblenë e përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilanci vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda tre muajve në vazhdim.

- Shoqëria propozon të shes apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- Shoqëria, brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasurine, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni-15 Përgjegjësit e administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë dhe ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të përcaktuara nga asamblenë që sjellin dem shqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshje, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarë sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU-4 VITI FINANCIAR DHE EKSPERTET

Neni-16 Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni- 17 Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregëtare të shoqërisë, atë gjithëvjetore dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoj ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU - 5 PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni – 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- 1- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- 2- me vendim të asamblese se ortakeve;
- 3- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- 4- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- 5- me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likujdim e siper”

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

Neni – 19 Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit 9901 dt 14-04-2012 “Per tregetet dhe shoqerite tregtare”

Neni – 20 Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregetet dhe shoqerite tregtare”

, Kodi civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaku i vetem

I Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “PRIME ELITE,,
Sh.p.k

Engelantina Prifti

